

Ndryshimi i furnizuesit

Rregullore për ndryshimin e furnizuesit e miratuar nga ERE përcakton:

Ka të drejtë të bëjë kërkesë për ndryshimin e furnizuesit:

- cdo klient i energjisë elektrike që ka ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.
- edhe çdo klient debitorë ndaj furnizuesit të mëparshëm, me kushte që:
 - Debia të merret përsipër nga furnizuesi i ri, sipas një marrëveshje të lidhur nga palët:
- Në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe klientit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

Ndërprerja e furnizimit

- Në qoftë se Klienti nuk respekton afatet e pagesave ndaj furnizuesit të mëparshëm, këtij të fundit (Furnizuesit të mëparshëm) i lind e drejta të kërkojë menjëherë pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për ish klientin e tij dhe në këtë rast klienti nuk do të furnizohet me energji elektrike nga asnjë furnizues alternativ.
- Në çdo rast Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë Furnizuesin aktual dhe atë të mëparshëm për ekzekutimin e ndërprerjes së kërkuar brënda 48 orëve.

Procedura për ndryshimin e furnizuesit

- ▶ Paraqitjen e një Kërkesë dhe dokumentacioni pranë selive të furnizuesit aktual ose nëpërmjet postaj jo më vonë se 15 ditë përpara periudhës së vlefshme.
- ▶ Personi i përcaktuar nga Furnizuesi për pranimin e dokumentacionit do të konfirmojë/vërtetojë marrjen dhe pranimin e aplikimit e tyre.
- ▶ Pranimi i kërkesës për ndryshimin e furnizuesit do të konsiderohet i vlefshëm në datën kur ai pranohet, sipas afateve të përcaktuara në rregullore.
- ▶ Me pranimin e kërkesës për ndryshimin e furnizuesit nga furnizuesi aktual, klientit i lind e drejta për të aplikuar pranë cilitdo furnizues/furnizuesve të zgjedhur prej tij.